



VENDIM

Nr.89, Datë 07.06.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS “PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET
E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI DHE ERA”**

Në mbështetje të nenit 10 dhe 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, nenit 19 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.06.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike, në lidhje me fillimin e procedurave “Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”,

Konstatohet se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në bazë të nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.
- VKM nr.369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

- Në pikën 1 të nenit 10 të Ligjit Nr 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” parashikohet se : “Mbështetja sipas kontratës për diferencë nuk zbatohet për prodhuesit me përparësi: a) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 MW; b) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike **deri në 3 MW për energjinë e erës**; c) për projektet demonstruese.”
- VKM nr.369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” shprehet se: “Ligji i ri (7/2017) parashikon vendosjen e tarifave FIP (Feed-In-Premium) me anë të një procesi konkurrues, jo diskriminues të tenderimit (ankande) nëpërmjet Kontratave për Diferencë (CfD), ndërsa instalimet e reja **mbi 2 MW** përjashtohen nga procesi konkurrues me çmimin tavan që do të vendoset bazuar në këtë metodologji.
- Metodologjia e miratuar me VKM nr.369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” në pikën 2 të përfundimeve shprehet: “Mbështetur në ligjin 7/2017, neni 10, pika 3, Enti Rregullator i Energjisë do të miratojë çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, **në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017 sipas parashikimeve të kësaj Metodologjie**, bazuar në referencat e tabelës së mësipërme përsa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim”.
- Mbështetur në neni 10, pika 3 të ligjit Nr 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e tjerë me përparësi, e cila duhet të përcaktojë kriteret e llogaritjes së çmimit, bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur. ERE përcakton çmimin bazuar në kriteret e përcaktuara tek kjo metodologji.
- Metodologjia e miratuar me VKM nr.369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” nuk është hartuar në formën që duhet të ketë një metodologji, por si një material shpjegues që konkludon me përcaktimin e çmimit për vitin 2017, atribut që sic shpjeguar më sipër, referuar ligjit Nr 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” e ka ERE e cila në çdo rast për qëllime të përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga çdo prodhues tjetër me përparësi vepron në përputhje

me përcaktimet e ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Vendosja e një çmimi blerjeje për impiantet e vogla vetëm për vitin 2017, nuk mund të shërbejë për të nxitur investimet në këto lloj burimesh të vogla, të cilat duhet të kenë një perspektivë afatgjatë të kthimit të investimit.
- Sa më sipër, vendosja e këtij çmimi në metodologji i shërben më shumë qëllimit të kryerjes së tenderimit të impianteve që përfitojnë mbështetje nga Kontrata për diferencë.
- Konstatohet gabim i dukshëm në llogaritjen e çmimit për vitin 2017 në tabelën bashkëlidhur vendimin të miratuar me VKM nr.369, datë 26.04.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”. Llogaritja e çmimit rezulton të jetë e bazuar në LCOE(kosto e niveluar e energjisë) dhe WACC.Bazuar në shifrat e evidentuara në tabelë, për periudhën 2017-2019 LCOE e PV(foto voltaikët) është më e lartë se LCOE e Erës , ndërsa WACC rezulton i njëjtë.
- Sa më sipër do të gjeneronte një çmim më të lartë për energjinë e prodhuar nga era sesa energjia e prodhuar nga dielli, por tabela tregon të kundërtën.
- Janë konstatuar paqartësi në lidhje me referencat orientuese në llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, mes VKM nr.369, datë 26.04.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” dhe Ligjit Nr 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës “Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”.
2. T’i kërkohet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë sqarim dhe saktësim i referencave të kuadrit ligjor rregullator, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.